



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	232/16
Nr. i fq. / Br. st	- 8 -
Data: / Datum	24. 11. 2016
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E IX-të E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRIË, MBAJTUR MË 27 TETOR 2016

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakte Dushi, Finesë Cakoli, Habib Mustafa, Habibe Gërxfhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e Komiteteve Konsultative dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – pasi hapi punimet e mbledhjes së kuvendit, iu referua nenit 10 të Ligjit për Zgjedhjet në lidhje me nenin 35 të LVL për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale, si dhe në mbështetje të vendimit të KQZ-së për zëvendësimin e anëtarës së kuvendit nga radhët e LDK-së, ku në këtë rast ftoi Finesë Cakolin që të jep betimin si anëtare e re e kuvendit. Në fund të diskutimit paraqiti dy pika shtesë në pikën në të ndryshme që të futen në rend të ditës.

Finesë Cakoli, anëtare e kuvendit – dha betimin (deklaratën) solemne para anëtarëve të kuvendit, në ç'rast u bë anëtare e kuvendit me të drejta të plota.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – kërkoi që pika 3 të hiqet nga rendi i ditës për arsye se nuk e kishin materialin e mjaftueshëm për të diskutuar në lidhje me këtë pikë, të cilin material e kishin kërkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, mirëpo ky material nuk ishte aty, gjithashtu kishin kërkuar edhe sqarime në lidhje me këtë pikë, meqë është dokument shumë me rëndësi. Po ashtu kërkoi që në muajin e ardhshëm të mblidhemi dhe të diskutojmë edhe njëherë në lidhje me këtë plan, ku kërkoi që ky dokument t'u dërgohet edhe në formë të shkruar. Në emër të grupit parlamentar dhe si subjekt propozoi që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës dhe në muajin nëntor të mblidhen edhe njëherë meqenëse ky plan ka shumë rëndësi të aprovohet në mënyrë konsensuale nga të gjitha subjektet politike, nga grupet e interesit pas sqarimit në detaje të këtij plani.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – mbështet atë çfarë tha parafolësi i tij, duke shtuar se nuk kishte material në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës dhe se është diskutuar vetëm në mënyrë verbale pa pasur material bazë për këtë çështje me rëndësi. Pastaj ceku se nevojitet vërtet një pjesëmarrje e gjithë të interesuarve, grupeve të interesit, grupeve dhe partive politike

me qëllim që të kemi një transparencë të plotë sepse në të kundërtën do të kemi paragjykime në lidhje me interesat e caktuara të dikujt në kontekst të aprovimit të këtij plani. Mandej vlerësoi se ky dokument me rëndësi të veçantë është mirë që të aprovohet në mënyrë koncesuale, ku gjatë debatit do të ofroheshin të gjitha argumentet dhe provat dhe që kjo çështje do të shohitej në maksimumin e saj dhe në fund ky dokument të aprovohet me konsensus të përbashkët politik.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të LDK-së u pajtua që pika 3 të hiqet nga rendi i ditës për faktin se kjo pikë nuk është e përpunuar si duhet dhe për këtë mungon materiali. Në fund ceku se ky dokument duhet të aprovohet me konsensus të përgjithshëm politik dhe me pajtueshmërinë e të gjitha grupeve të interesit.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se kjo pikë e rendit të ditës duhet të shtyhet për një nga mbledhjen e ardhshme të kuvendit me qëllim që ky dokument të përgatitet në mënyrë sa më të mirë, në të kundërtën nëse kjo pikë futet në rend të ditës, grupi kuvendar i VV-së do të votojë kundër.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se kuvendi i komunës para dy viteve ka marrë vendim për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe në këtë drejtim Drejtoria e Urbanizmit ka bërë një punë të madhe, ku janë zhvilluar mbi 20 takime (debate publike) me qytetarë dhe grupe të interesit, dhe që këtij procesi i ka paraprirë Drejtoria e Urbanizmit në bashkëpunim me USAIDIN, si dhe disa nga anëtarët e kuvendit kanë qenë të involvuar në këtë proces. Aprovimi i këtij plani është ngadalësuar për faktin se është dashur të aprovohet Plani i Konservimit të Komunës, si dhe Ministria e Planifikimit Hapësinorë kishte kërkuar që nga ky dokument të hiqet termi revidim dhe pas kësaj ky dokument kishte shkuar në diskutim publik edhe për 30 ditë tjera. Në kuptim të plotësimit të këtij dokumenti Drejtoria e Urbanizmit është dashur që të inkorporojë mbi 70 komente, të cilat duhet të harmonizohen me ligjet relevante të Republikës së Kosovës. Pastaj ai ceku se në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa është kërkuar nga të gjitha partitë politike të përfaqësuara në kuvend, por edhe jashtë kuvendit, t'i ofrojnë propozimet e tyre për këtë dokument, por deri më tani nuk ka pasur asnjë propozim. Tutje ai vlerësoi se shtyrja e aprovimit të këtij plani në njëfarë forme është duke e “bllokuar” qytetin për faktin se Plani Zhvillimor Komunal është pika më e rëndësishme që kuvendi komunal mund ta aprovojë brenda një mandati. Në fund ai ceku se për këtë dokument duhet të thirret një mbledhje e veçantë ku do të debatohej gjerë e gjatë dhe shtruar me qëllim të shterrjes së debateve dhe në fund të aprovohet alternativa më e mirë e mundshme e këtij plani.

Kuvendi i Komunës me 29 vota “për”, të tjerat abstenim vendosi që pika e 3 e rendit të ditës Plani Zhvillimor Komunal të hiqet nga rendi i ditës.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt; korrik, gusht, shtator 2016;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
4. Shqyrtimi i informatës lidhur me aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-shtator 2016;
5. Shqyrtimi i informatës lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimin e deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-shtator 2016;
6. Të ndryshme.

- a). Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.197/14 i datës 29.09.2014 për emërimin e anëtares së KPF-së;
- b). Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta.

1.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin e mbledhjes paraprake të KK-së.

2.Shqyrtimi i informatës për të hyrat vetanake dhe shpenzimet për muajt; korrik, gusht, shtator 2016;

Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se tek Drejtoria e Urbanizmit vlen të ceket se shfrytëzimi i pronës komunale ku kemi të planifikuara 60.00.00 euro, kurse janë realizuar vetëm 34.864.81 ose 58% çka flet për neglizhencën e organeve komunale për inkasimin e borxheve për shfrytëzimin e pronës komunale. Tek tabela e shpenzimeve kemi vërejtje sepse siç dihet cilësia e çdo pasqyre financiare është shpalosja e të dhënave me shkrim në mënyrë që të kuptohen më mirë nga publiku p.sh te Kategoria e pagave kemi 100.000.00 euro më tepër të shpenzuara se sa të planifikuara dhe shtrohet pyetja a kemi rritja të numrit të punëtorëve, a kemi rritje të koeficientit të pagave apo kemi rritje të mëditjeve. Pastaj tek investimet kapitale kemi 1.200.00.00 euro të realizuara më pak sesa të planifikuara dhe për këtë nuk jepet kurrfarë shpjegimi se a janë mjetet e zotuar për këtë shumë kur dihet se fundi i këtij muaji është afati i fundit kur bëhet zotimi i mjeteve për investime kapitale.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – ai kishte vërejtje gabime në titullin e informatës ku është cekur periudha e informimit janar - shtator sepse kjo përfshinte një periudhë nëntëmujore, ndërsa raporti ka të bëjë me periudhën tremujore, andaj ceku se kjo mund të jetë gabim teknik. Sa i përket tatimit në pronë potencoi që kemi një rritje në krahasim me vitin e kaluar për 110% , ndërsa për muajt e tjerë nuk është shndërruar në përqindje vetëm për muajt 4-5-6 për buxhetin e planifikuar për periudhën e caktuar dhe të hyrat e realizuara, ndërsa për muajt e tjerë nuk ka përqindje. Ai shprehu një përgëzim për punën që është bërë edhe pse ka pas mundësi me u ngritë edhe më tepër se 110% në buxhetin e planifikuar për këtë vit. Pastaj tek shfrytëzimi i pronës publike ai tha se kanë qenë të planifikuara 60.000, ndërsa janë shpenzuar vetëm 34.864 euro ose 58% ku mendoi se shfrytëzimi i pronës publike është i dobët pra realizim i dobët i të hyrave në këtë segment. Ndërsa për infrastrukturë dhe gjëra tjera ai tha se nuk duhet të merren si të përgjithësuara, por të precizohen sikur gjëra të tjera ku vetëm disa janë precizuar p.sh “Lumi Tërstena”, rruga “Arsim Muzaqi”, kurse projektet tjera si “ndërtimi i trotuareve” janë përcaktuar në formë paushalle, tek ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit kërkoi të bëhet specifikimi i lokaliteteve në të cilat është rregulluar rrejtja. Rrugët e rendit të IV-të po ashtu duhet të precizohen se ku janë përfunduar, kanalizimet gjithashtu duhet të dihet se ku janë ndërtuar në cilat vendbanime. Tutje tek kategoria e subvencioneve, e si dhe e mallrave dhe shërbimeve duhet të dihen shpenzimet e udhëtimeve zyrtare ku ato për këtë vit janë më të vogla sesa në vitin 2015, por sido që të jetë ato duhet të pasqyrohen në këtë informatë (ku duhet të dihet qëllimi dhe dobia e këtyre udhëtimeve). Pastaj tek kodi ekonomik “Furnizim dhe pastrim” kemi rritje të shpenzimeve në vlerën prej 110 % ku në vitin 2015 kemi pasur shpenzime prej 6,331.39 € në vitin 2016 kemi 14,986.68 €. Furnizimi me veshmbathje në vitin 2015 kemi pasur 1,939.39, kurse këtë vit shpenzimet janë rritur në vlerën prej 10,800.68 €, këtu ceku se duhet të bëhet e ditur se cilat familje janë furnizuar me këto veshmbathje. Lidhur me shpenzimet për karburante për vetura shprehu përgëzime për siç tha ulje të këtyre shpenzimeve nga 45,973.18 € sa kishim në vitin 2015 në këtë vit kemi 37,833.04 €. Mirëmbajtja e ndërtesave duhet të përcaktohet se për cilat ndërtesa bëhet fjalë të cilat janë mirëmbajt. Në fund tha se mirëmbajtja e rrugëve

lokale, duhet të specifikohet se cilat rrugë i ka mirëmbajt komuna në vitin 2016 ku janë shpenzuar 15,320.00 € dhe të sqarohet fakti se përse në vitin 2015 rrugët nuk janë mirëmbajtur fare për shkak se nuk kemi fare shpenzime.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se ky raport tremujor më tepër i ngjan një pasqyre tabelare, për faktin se në kuptimin tekstual nuk kemi ndonjë përshkrim se cilat karakteristika e kanë përcjell këtë periudhë raportuese, se çfarë është, a kemi mobilizim se dhe nga i kemi të hyrat më të mëdha. Tutje shtoi se në bazë të shifrave të pasqyruara në këtë dokument shihet se kemi një ndryshim dhe se nuk thuhet rastësisht se statistika është përmbledhje e shifrave të sakta dhe të pasakta. Andaj nëse hyjmë në përmbajtje shihet diçka tjetër ku kemi një ndryshim ku për periudhën e kaluar kemi pasur 48 % në realizimin e investimeve kapitale tani kjo shifër është 65 %, kurse te të hyrat vetanake herën e kaluar kemi pasur 67 % tani ato janë në shifrën prej 80% që i bie se kemi një përmirësim në përgjithësi. Por nëse i analizojmë të hyrat vetanake të painkasuara apo borxhet e këqija në komunën tonë kemi diku apo saktësisht shuma e këtyre borxheve në shifra zyrtare sa i përket taksës në firmë është 533,528.52 € kurse, sa i përket tatimit në pronë borxhi i painkasuar apo shprehur në përqindje realizimi është 52,99 %, kurse të painkasuar kemi 2,193.301.59 €, e kjo nënkupton që kemi një shumë të madhe të mjeteve me të cilat do të kishim mundësi të përmirësojmë jetesën e qytetarëve tanë. Nëse shikohet inkasimi sipas vendbanimeve shihen dallime të mëdha, andaj nuk është e rastit që është dhënë kriteri që përcaktimi i orientimit të investimeve kapitale të bëhet sipas përqindjes së pagesës së tatimit në pronë për faktin se kjo kategori e të hyrave është burim i përhershëm i mbushjes së arkës së komunës. Në këtë kontekst ai shtroi nevojën që administrata komunale duhet të ketë një plan konkret me qëllim të inkasimit të këtyre të hyrave (borxheve). Në fund apeloj tek qeveria komunale dhe te të gjitha dikasteret komunale që të kemi një mobilizim të përgjithshëm për inkasimin e të hyrave komunale dhe ngritjen e performancës financiare të komunës, ku do të mundësohej përmirësimi i jetesë të qytetarëve të komunës sonë.

3.Shqyrtimi i Propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 20 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë në sipërfaqe prej 20 m² të marrë nga sipërfaqja e përgjithshme 14732 m² e cila është pjesë e ngastrës kadastrale nr.P-70202016-00001-1, Zona Kadastrale Vushtrri pronë e komunës.

2. Nga ngastra kadastrale e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi i jepet KEDS-it në shfrytëzim afatgjatë për 20 vite pa kompensim, sipërfaqja prej 20m² për vendosjen e trafostacionit.

3. Komuna me implementimin e Planeve Urbanistike siç janë: Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme, KEDS-i apo ndonjë subjekt juridik, i cili menaxhon në këtë trafostacion obligohet të largojë trafostacionin me të gjitha investimet e tyre.

4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5.Obligohet Kryetari i komunës dhe përfaqësuesi i autoritet qendror në cilësinë e dhënësit në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale në njërin anë dhe ndërmarrjes KEDS-it në anë tjetër (si shfrytëzues i pronës), që të nënshkruajnë kontratën.

6.Pjesë e këtij vendimi janë: certifikata për të drejtën e pronës, kopja e planit

4.Shqyrtimi i informatës lidhur me aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për periudhën janar-shtator 2016;

5.Shqyrtimi i informatës lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimin e deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-shtator 2016;

Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit – tha se lidhur me këtë informatë edhe në KPF kishte paraqitur disa sugjerime duke shuar se nevojitet një koordinim më i mirë mes Drejtorisë së Mjedisit, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Ekonomisë për një efikasitet më të madh në ngritjen e nivelit të pastërtisë. Tutje shtoi se Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit duhet të punojë në vetëdijesimin e qytetarëve, Drejtoria për Ekonomi duhet të angazhohet në trajnimin e qytetarëve sidomos në viset rurale, kurse Drejtoria e Shërbimeve Publike së bashku me kompaninë “Uniteti” kanë punuar në drejtim të ngritjes së cilës së shërbimeve për qytetarët e komunës tonë. Kur flitet për vetëdijesimin e qytetarëve në fushën e mbrojtjes së mjedisit atëherë mendohet në sensibilizimin e qytetarëve përmes fletushkave të ndryshme, mbajtjes së takimeve me qytetarë, pastaj të mbahen gara të ndryshme me nxënës. Në relacion të organizimit të trajnimeve vlerësoi se kishte me qenë shumë e nevojshme që në viset rurale të bëhet kompostimi i mbeturinave ku do të fitoheshin vlera të ndryshme (në ç’rast do të ulej sasia e mbeturinave). Në fund rekomandoi që të shpërblehet fshati apo lagja më e mirë apo më e pastër dhe kjo do të ndikonte në ngritjen e edukatës në lëmin e mbrojtjes së ambientit.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se informata lidhur me nivelin e pastërtisë dhe eliminimin e deponive ilegale në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-shtator 2016, por jo vetëm për këtë përuddhë, por në vazhdimësi gjendja e mbeturinave dhe e ambientit në qytet nuk është nivelin e kënaqshëm, kurse në fshatra ky shërbim nuk ofrohet fare. Ne kemi diskutuar në Komitetin për Politikë dhe Financa këtë problem, i cili është tepër shqetësues edhe për qytetin edhe për fshatra ku në mënyrë të vazhdueshme kanë kërkesa që t’u ofrohet ky shërbim dhe ta paguajnë atë. Drejtoria e Shërbimeve Publike së bashku me ne, një grup prej tre (3) vetash ku jemi përfaqësues të aksioneve të komunës në kompaninë regjionale “Uniteti” kemi bërë përpjeke që të ndryshojmë diçka në lidhje me këtë fenomen. Pra është shumë vështirë t’u premtohet qytetarëve se do të ketë pastërti dhe eliminim të deponive ilegale në këtë nivel që jemi. Ai tha se komuna duhet të marrë një hap vendimtar dhe të përcaktohet në dy alternativa për zgjedhjen e këtij problemi. E para është inicimi i menjëhershëm për formimin e kompanisë komunale edhe pse paraqiten disa probleme të vogla sepse komuna jonë është aksionare në kompaninë Regjionale “Uniteti” ku duhet të gjejmë formë ose t’i tërheqim aksionet atje ose të bëjmë kompensimin në mënyrën pa pagesë të deponimit apo të shfrytëzimit të depos në Koshtovë. Alternativa e dytë për zgjedhjen e këtij problemi është që të vendosen dhe të ndahen zonat dhe të shkohet në privatizim të shërbimeve pra në tender, zgjedhje tjetër është vështirë të gjendet. Realizimi i të hyrave sipas të dhënave në Komunën e Vushtrrisë është afër 52% çka paraqet se komuna lirshëm mund të marrë vendime për zgjedhjen e këtij problemi, pra me këtë angazhim të kompanisë dhe me këta paragon-blloka për mbledhjen e mbeturinave nuk është edhe ligjore të bëhet në atë formë, ku kompania “Uniteti” ka arritur realizim 52% të obligimeve të faturume. Në material ne kemi pa që komuna ka bashkëpunim me USAID-in me GIZI-n dhe se ka mundësi për përkrahje, por ato mund të ndodhin dhe janë të mirëseardhura po mund të mos ndodhin kurrë. Në fund ai kërkoi që të merret një qëndrim nëse është e nevojshme edhe me

vendim të kuvendit ku në një të ardhme të afërt të zgjidhet kjo çështje meqë kemi një gjendje të patolerueshme për të gjithë, ku të gjithë lumenjtë janë të ndotur për shkak të mosofrimit të shërbimeve adekuate për grumbullim të mbeturinave, ku edhe shumë rrugë janë në gjendje të mjerueshme nga mbeturinat. Pra është një gjendje kaotike ku me të vërtetë duhet që në mënyrën më të shpejtë të mundshme dhe me seriozitet shumë të lartë si nga komuna ashtu edhe nga të gjithë akterët relevant të mund të japin kontributin e tyre në këtë fushë.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket kësaj informate unë jam që tri (3) vite asamblist, kemi bërë plane, bashkëpunime, vizita në Suedi, kanë ardhur në vizita etj., kemi pasur ide të ndryshme, por gjendja në terren veç sa vije duke u bërë më keq. Ai vazhdoi me pyetje për organet përgjegjëse se a ka ndonjë plan konkret apo duhet të vazhdojmë siç kemi bërë deri tani me plane, vizita, shëtitje.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha se e përgëzon drejtorinë kompetente për iniciativat e saj në rregullimin e problemit të mbeturinave. Tutje shtoi se iniciativat e marra nga ana e drejtorisë, kanë hasur në “vesh të shurdhër” në kompaninë regjionale “Uniteti” dhe ky fakt e bënë tërësisht të papërgjegjshme këtë kompani. Pastaj vlerësoi se mënyra e menaxhimit të mjeteve financiare nga ana e kësaj kompanie lë për të dëshiruar dhe mundësitë për keqpërdorime janë evidente. Në kontekst të kësaj problematike, ai përgëzoi drejtorinë, për iniciativën e punësimit me kontratë mbi veprën për katër (punëtorë), si dhe një (1) punëtor teknik për mirëmbajtjen e sheshit dhe për këtë kërkoi që të merret edhe një punëtor që gjatë ditës të mirëmbahet sheshi. Mandej ai vlerësoi se shitësit ambulatorë në shesh duhet të sistemohen në mënyrë më të rregullt. Në fund ai ngriti shqetësimin e tij lidhur me një deponi ilegale në fshatin Pasomë, e që kërkoi që kjo deponi të largohet nga aty për shkak se ai terren (fushë) shfrytëzohet për kullosa të bagëtive dhe e njëjta po i rrezikon kafshët e rrjedhimisht edhe njerëzit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – kërkoi që pajisjet e njësisë së kompanisë “Uniteti” që merret me pastrimin e qytetit të Vushtrisë të ndërrohen për faktin se ato janë të pandryshuara për një kohë të gjatë e të cilat janë vjetërsuar tej mase, kurse ndërrimi i tyre do të ndikonte në përmirësimin dhe ndryshim pozitiv gjendjes. Tutje shtoi se bllokimi i shtretërve të lumenjve siç është ai “Podranqa” në të cilin është “rrëzuar” një urë gjatë punimeve dhe ashtu ka mbetur pjesët e betonit në lum, ku tash kur do të kemi shira, lumi do të del nga shtrati dhe do ta vërshojë atë pjesë të qytetit. Pastaj lidhur me shëtitoren buzë lumit “Silnica” e cila kohëve të fundit është dëmtuar duhet të gjenden mundësi që ajo të rregullohet qoftë edhe përmes ndonjë donacioni nga organizatat ndërkombëtare. Lidhur me çështjen e formimit të ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave në pronësi komunale vlerësoi se kjo çështje është referencë e ligjeve që aprovohen nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë kontekst çmoi si shumë relevante që në Asociacionin e Komunave të shtrohet çështja e ndryshimit të kuadrit ligjor ku do mundësohej formimi i këtyre kompanive për menaxhimin e mbeturinave.

Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit – vlerësoi si shumë të rëndësishme që qytetarët e komunës sonë të vetëdijesohen në kuptimin e ruajtjes së mjedisit dhe moshedhjes së mbeturinave në vendet joadekuate. Gjithashtu ai ceku se duhet të zbatohet rregullorja komunale për mbeturinat, ku do të shqiptoheshin gjobat nga Drejtoria e Inspektimeve dhe kjo sigurisht se do të ndikonte në ndërrimin e mentalitetit në aspektin e trajtimit dhe ruajtjes së ambientit. Një tjetër aspekt ku do të mund të ndikohej në përmirësimin e gjendjes janë edhe shkollat, të cilat do të mund të mbanin leksione për ambientin, por edhe OJQ-të e ndryshme do të mund të ndikonin në përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Bajrm Beqiri, zyrtar i DSHP-së - tha se lidhur me gjendjen e mbeturinave dhe të ambientit në përgjithësi nevojitet një debat gjithëpërfshirës dhe mirë do të ishte që të mbahej edhe ndonjë seancë e kuvendit ku temë ekskluzive do të ishte menaxhimi i mbeturinave. Tutje shtoi se DSHP-ja në bashkëpunim me drejtoritë tjera është duke bërë përpjekje maksimale për përmirësimin e gjendjes së mjedisit. Në këtë relacion përmendi faktin se komuna jonë tani ka aprovuar Planin për Menaxhimin e Mbeturinave, si dhe rregulloren. Në vazhdim ai paraqiti

sqarime lidhur me aktivitetet dhe punët e drejtorisë në aspektin e menaxhimit të mbeturinave dhe u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Ali Jonuzi, anëtar i kuvendit – tha se i tërë programi të hidhet në praktikë sepse është një program shumë i nevojshëm. Ai shtoi se në këto çështje kishte një neglizhencë të inspektorëve duke cekur se nuk kishte hasur në ndonjë rast kur një inspektor ia kishte tërhequr vërejtjen dikujt. Vërtet duhet që inspeksioni të ndajë gjoba për familjet që nuk i kryejnë obligimet si duhet. Mandej tha se kishte përmendur edhe më herët po e cek edhe tani se në fushën mes fshatit Banjskë dhe fshatit Pasomë vite më herët një ekskavator bënte shpërndarjen e atyre mbeturinave, tashmë ajo fushë është mjerim duke e krahasuar me vitet e mëhershme kur kjo fushë ishte e mbuluar me gjelbërim. Në asnjë rast, asnjë grup inspektorësh nuk kanë dal ta shohin gjendjen në atë fushë apo nuk ia ka tërhequr vërejtjen dikujt apo dënuar ndonjë person. Ai bëri kërkesë në organet e komunës që të ndërmarrin diçka sepse vërtet është bërë një grumbull mbeturinash të llojeve të ndryshme të hedhura nga kompani të mëdha që kryesisht merren me ndërtimin e objekteve të mëdha. Pra kërkoi që kjo kërkesë të merret parasysh dhe ta vendosin një ekskavator që të rrafshojë atë grumbull mbeturinash, të cilat ia kanë prishur bukurinë asaj pjese.

6.Të ndryshme.

a).Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Nr.197/14 i datës 29.09.2014 për emërimin e anëtares së KPF-së;

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se grupi kuvendar i LDK-së propozon Syzana Sylja për anëtare të KPF-së ku në këtë rast duhet respektuar kuotën gjinore që është e përcaktuar me norma ligjore.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë Vendim ndryshohet dhe plotësohet Vendimi 01Nr.197/14, dt.29.09.2014 për emërimin e anëtarëve të KPF-së me sa vijon:

Emërohet anëtare e KPF-së Syzana Sylja në vend të Fatime Hazirit nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të obligohen: Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Kuvendit.

b).Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim-vendimit për shpalljen e konkursit për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim shpallet konkursi për anëtarësim në Komitetin Konsultativ për Personat me Nevoja të Veçanta.

2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, duke përfshirë qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare, të cilët janë njohës të fushëveprimtarisë së komunës.

3. Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenin 4.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - ngriti një shqetësim të qytetarëve në lidhje me rrugën “Hys Popova” i cili kishte rrjedhje të gypit të ujit në dy pjesë dhe se ndriçimi në 80% të rasteve nuk funksionon, kurse pusetat e ujëmbledhëse gjithashtu nuk funksionojnë, kështu që për këto çështje ai kërkoi që të intervenohet sa më shpejt që të jetë e mundur nga organet komunale.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se në saje të asaj që në sheshin e qytetit kanë mbetur shumë punë pa u përfunduar, një çështje e tillë ka të bëjë me fajin e KEDS-it i cili nuk ka realizuar infrastrukturën nëntokësore (vendosjes së kablove elektrike dhe ndriçimit). Në këtë kontekst ai sugjeroi që në disa shtylla metalike që janë të vendosura në pjesë ku bëhet lidhja, janë të zhvendosur “kapakët”, kabllot elektrike janë të shkurtuara dhe të hapura dhe kështu ato paraqesin rrezik për qytetarët, andaj lidhur me këtë kërkoi të ndërmerren veprime urgjente për rregullimin e këtij problemi nga organet kompetente komunale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.

Bastri Duraku

Shpëtim Zhegrova

Procesmbajtës

Kryesues i Kuvendit

3. Kushtet e konkursit duhet të jenë në përputhshmëri me nenin 4.4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryesuesi dhe Sekretaria e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit - ngriti një shqetësim të qytetarëve në lidhje me rrugën “Hys Popova” i cili kishte rrjedhje të gypit të ujit në dy pjesë dhe se ndriçimi në 80% të rasteve nuk funksionon, kurse pusetat e ujëmbledhëse gjithashtu nuk funksionojnë, kështu që për këto çështje ai kërkoi që të intervenohet sa më shpejt që të jetë e mundur nga organet komunale.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se në saje të asaj që në sheshin e qytetit kanë mbetur shumë punë pa u përfunduar, një çështje e tillë ka të bëjë me fajin e KEDS-it i cili nuk ka realizuar infrastrukturën nëntokësore (vendosjes së kablove elektrike dhe ndriçimit). Në këtë kontekst ai sugjeroi që në disa shtylla metalike që janë të vendosura në pjesë ku bëhet lidhja, janë të zhvendosur “kapakët”, kabllo të elektrike janë të shkurtuara dhe të hapura dhe kështu ato paraqesin rrezik për qytetarët, andaj lidhur me këtë kërkoi të ndërmerren veprime urgjente për rregullimin e këtij problemi nga organet kompetente komunale.

Mbledhja përfundoi në orën 11:10.


Bastri Duraku



Procesmbajtës



Shpëtim Zhegrova



Kryesues i Kuvendit